

PROCESVERBAL
nga seanca e 17-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 12.5.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivoli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski dhe Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të punësuar nga shërbimi profesional: mr. Dragica Ljubevska, dr. Ivana Stojanovska, Emilija Janevska, Cvetanka Mitrevska, Argjend Xhelili, Maja Damevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: Stojan Trpçevski – redaktor i programit informativ i MTV-së.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 17-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 11:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 16-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 5.5.2026.
2. Propozim-vendim për përcaktimin e listës së eventeve me rëndësi të madhe për publikun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
3. Propozim-vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiotelevizive Radio Pella ShPKNJ, fsh. Konjari i Vogël, Prilep.
4. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të NPR Makedonska Radiotelevizija Skopje - Televizioni i Maqedonasë - shërbimi i parë programor (RTM1), për shkelje të nenit 55, paragrafi (1) të LShMAAV.
5. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të NPR Makedonska Radiotelevizija Skopje - Televizioni i Maqedonasë - shërbim i pestë programor (RTM5), për shkelje të nenit 55, paragrafi (1) të LShMAAV.

6. Informacion në lidhje me mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga ana e IPSh SBGMP 13 Nëntori Shkup, të parashikuara në Kontratën për donacion, me propozim-marrëveshje për ndërprerjen e kontratës.
7. Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizimin e shërbimit me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizime publike - dezinfektim dhe spërkatje nga insekte.
8. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën në vijim të furnizimit publik-shërbim: mirëmbajtja e faqeve të internetit të Agjencisë.
9. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 16-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 27.4.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi se Vendimi ekzistues për evente me rëndësi të madhe për publikun e Republikës së Maqedonisë së Veriut është miratuar në vitin 2015, dhe ndërkohë kanë ndodhur disa ndryshime që imponojnë nevojën për përditësimin dhe ndryshimin e tij. Ai theksoi se Drejtori i Radiotelevizionit të Maqedonasë ka paraqitur iniciativë për ndryshime dhe plotësime, përkatësisht për miratimin e vendimi të ri për evente me rëndësi të madhe. Në përputhje me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për akt nënligjor, ai propozoi që Këshilli të miratojë Draft-vendimin dhe të hapë debat publik në kohëzgjatje prej 30 ditësh. Ai shpjegoi se, përveç propozimeve të përfshira në iniciativën e Radiotelevizionit të Maqedonasë, teksti përfshin edhe propozime shtesë që rrjedhin nga Agjencia, dhe gjatë debatit publik mund të propozohen ndryshime dhe plotësime të reja.

Në lidhje me përmbytjen e Draft-vendimit, Drejtori informoi se Lojërat olimpike dimërore dhe verore, të cilat në vendimin ekzistues rregullohen si dy pika të veçanta, tani janë bashkuar në një kategori të përbashkët. Përveç kësaj, propozohet të përfshihen pesë kategori të reja eventesh, përkatësisht:

- kampionatet botërore dhe evropiane të atletikës;
- lojërat paraolimpike dimërore dhe verore, duke përfshirë ceremonitë e hapjes dhe mbylljes, garat finale dhe garat në të cilat marrin pjesë sportist nga Republika e Maqedonisë së Veriut;
- lojërat olimpike për të shurdhër, së bashku me ceremonitë e hapjes dhe mbylljes, finalët dhe garat ku marrin pjesë sportistë nga Republika e Maqedonisë së Veriut;
- ndeshjet e ligës kombëtare UEFA dhe Ligës së Konferencës Evropiane UEFA në garën e meshkujve për seniorë, duke përfshirë ndeshjet nga fazat e rregullta eliminatorë, gjysmëfinale dhe ndeshja finale;

- shtimi i kategorive lidhur me kampionatet botërore dhe evropiane në disa sporte.

Ai theksoi se ndeshjet kualifikuese të ekipit kombëtar të futbollit të Maqedonisë për Kampionatin Botëror dhe Evropian, të cilat më parë rregulloheshin në dy pika të ndara, me vendimin e ri janë bashkuar në një pikë të përbashkët. Gjithashtu, ndeshjet që lidhen me Kampionatin Botëror dhe Evropian të Futbollit janë bashkuar dhe plotësuar me ndeshje nga fazat e grupeve dhe eliminatorëve.

Përveç kësaj, propozohet të përfshihen ndeshjet nga fazat e rregullta dhe eliminatorëve të Ligës së Kampionëve UEFA dhe Ligës së Evropës UEFA. Propozohet të zgjerohet mbulimi i kampionateve botërore dhe evropiane në basketboll, volejboll dhe hendboll për të përfshirë ndeshjet nga fazat e grupeve eliminatorëve, dhe në volejboll për të përfshirë ndeshjet në garën e femrave.

Lidhur me hendbollin, ai sqaroi se terminologjia "Kupa Evropiane e Ndeshjeve" po zëvendësohet me "Liga e Kampionëve EHF në Hendboll", duke përfshirë gjithashtu ndeshjet nga fazat e grupeve dhe eliminatorëve.

Drejtori informoi gjithashtu për ndryshim teknik në pikën 1 të Vendimit, në të cilën fshihen fjalët "taksë radiodifuzive", duke pasur parasysh se kjo tarifë u hoq në vitin 2017.

Ai njoftoi se gjatë seancës së hapur Agjencia do të organizon takim me të gjitha palët e interesuara, me qëllim shqyrtim plotësues të Draft-vendimit.

Kryetari i Këshillit, Sasho Stefanovski, propozoi pas përfundimit të seancës së hapur, në seancën në të cilën do të shqyrtohet teksti përfundimtar i Vendimit, të ftohet dhe drejtori i Radiotelevizionit të Maqedonasë, me qëllim sqarimin e çështjeve të caktuara që lidhen me materialin e lëndës.

Këshilltarja Gordana Majnova bëri pyetje në lidhje me transmetuesit e kualifikuar që plotësojnë kushtet për transmetimin e ngjarjeve me rëndësi të madhe, përkatësisht nëse ata kanë të drejtë pa pagesë t'i transmetojnë ngjarjet dhe nëse transmetimi mund të jetë drejtpërdrejt apo me vonesë.

Në përgjigje, drejtori Trajčevski sqaroi se transmetuesit kanë të drejtë të transmetojnë ngjarjet, por nuk i marrin pa pagesë, por në mënyrë të pavarur përkundrazi duhet të sigurojnë dhe paguajnë të drejtat e transmetimit.

Kryetari Stefanovski gjithashtu theksoi se të drejtat për ngjarjet sportive paguhen, prandaj shërbimi publik ka detyrimin të sigurojë mjete financiare për transmetimin e tyre.

Drejtori Trajčevski sqaroi se të drejtë për transmetim të këtyre ngjarjeve nuk ka vetëm Radiotelevizioni i Maqedonasë, por edhe televizione e kualifikuara tokësore, përkatësisht Sitel, Kanal 5, Alsat-M, Telma dhe Alfa.

Këshilltari Viktor Pavlovski theksoi se pjesë të këtyre ndeshjeve deri më tani janë transmetuar në sërbiisht ose kroatisht përmes kanaleve të huaja dhe shprehu pritshmëri se ndryshimet e propozuara do të mundësojnë transmetimin e tyre edhe në gjuhën maqedone.

Në këtë drejtim, drejtori Trajčevski shpjegoi se gjatë ritransmetimit të kanaleve të huaja, programi transmetohet në gjuhën në të cilën transmetuesi i huaj e ka siguruar. Megjithatë, nëse transmetues i kualifikuar nga Republika e Maqedonisë së Veriut ka siguruar të drejtat për ngjarje konkrete, i njëjti do të transmetohet në gjuhën për të cilën transmetuesi ka marrë lejen.

Në pyetje shtesë nga Viktor Pavlovski nëse është e mundur transmetimi i njëkohshëm i ngjarjeve dhe në Radiotelevizionin e Maqedonasë edhe në kanale të tjera, drejtori sqaroi se kjo varet nga lloji i të drejtave të blera, përkatësisht nëse bëhet fjalë për të drejta ekskluzive për transmetim tokësor apo kabllor.

Këshilltarja Gordana Majnova bëri pyetje shtesë nëse, në rast se Radiotelevizioni i Maqedonasë ka të drejta ekskluzive për ngjarje të caktuar, transmetues tjetër mund t'i blejë këto të drejta prej tij.

Drejtori Trajčevski sqaroi se të drejtat ekskluzive blihen pikërisht me qëllim që transmetues tjetër të mos ketë të drejtën e transmetimit, por që mbajtësi i të drejtave teorikisht të mund t'i përjashtoj ose t'i rishesë.

Gjithashtu këshilltari Petar Xhurovski iu bashkua diskutimit, duke pyetur nëse shërbimi publik ka përparësi në blerjen e të drejtave për transmetimin e këtyre ngjarjeve.

Drejtori Trajčevski theksoi se Radiotelevizioni i Maqedonasë nuk ka epërsi ndaj transmetuesve të tjerë të kualifikuar, por përkundrazi të gjithë kanë të drejtë të barabartë për pjesëmarrje në procedurat për sigurimin e të drejtave për transmetim.

Zëvendësja e kryetarit të Këshillit, Zirjeta Jajaga, theksoi se, pas realizimit të debatit publik në kohëzgjatje prej 30-ditësh, është e nevojshme të organizohet takim me të gjithë palët e interesuara, përfshirë dhe operatorët televizivë, me qëllim specifikimin më të detajuar të kriterëve dhe sqarimin e të gjitha dilemave dhe çështjeve të ngritura gjatë diskutimit, përpara se të merret vendimi përfundimtar.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Draft-vendimin për përcaktimin e listës së ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Draft-vendimin për përcaktimin e listës së ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë, me qëllim që të sigurohet debat publik në kohëzgjatje prej 30 ditësh, për t'u mundësuar të gjitha palëve të interesuara të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre.

Pika 3

Cvetanka Mitrevska, udhëheqëse e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, shpjegoi se Shoqëria Tregtare Radiodifuzive Radio Pela ShPKNJ, fsh. Malo Konjari, Prilep, është posedues i lejes për transmetim në radio, të lëshuar në vitin 2017 me vlefshmëri prej 9 vitesh, vlefshmëria e së cilës skadon më 14 maj 2026. Ajo theksoi se bëhet fjalë për shërbim programor në radio me format të përgjithshëm muzikor-fjalor në gjuhën maqedonase, i cili transmetohet nëpërmjet transmetuesi tokësor në nivel lokal, në zonën e Komunës së Krivogashtanit. Ajo informoi se transmetuesi më 9 prill 2026, drejtuar Agjencisë ka paraqitur Kërkesë për vazhdimin e lejes për transmetim në radio, në formularin e publikuar në faqen e internetit të Agjencisë. Fillimisht kërkesa e paraqitur nuk ishte plotësisht e plotë, prandaj më 16 prill 2026, transmetuesi është udhëzuar të plotësojë dokumentacionin. Pas dorëzimit të kërkesë të harmonizuar dhe të korrigjuar, Agjencia vazhdoi shqyrtimin e saj, gjatë së cilës është konstatuar se kërkesa është e saktë dhe e plotë.

Për më tepër, u krye analizë mbi punën e transmetuesit dhe u konstatua se Radio Pella i përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 79 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio

dhe Audiovizuele për vazhdimin e lejes për transmetim në radio. U përcaktua se gjatë periudhës së vlefshmërisë së lejes, transmetuesi nuk ka kryer ndonjë shkelje serioze të nenit 79, paragrafi 4 i Ligjit, prandaj propozohet që Këshilli të miratojë Kërkesën e paraqitur për vazhdimin e lejes për transmetim në radio.

Këshilltari Petar Xhurovski theksoi se transmetuesi veproi sipas rekomandimeve të Agjencisë dhe me kohë i korrigjoi mangësitë në dokumentacion, duke vlerësuar se ekzistojnë kushte për vazhdimin e lejes.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio Pela ShPKNJ P, fsh. Malo Konjari, Prilep, PA1 nr.08-313 datë 3.7.2017, për periudhë prej 9 (nëntë) vitesh, për periudhë nga 15.5.2026 deri më 14.5.2035.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Vendimin për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio Pela ShPKNJ P fsh. Malo Konjari, Prilep ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të RMV-së" dhe në faqen e internetit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike t'ia dorëzojë transmetuesit Vendimin për vazhdimin e lejes për transmetim në radiok të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio Pela ShPKNJ P, fsh. Malo Konjari, Prilep.

Pika 4 dhe Pika 5

Në lidhje me Pikat 4 dhe 5, drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, theksoi se të dyja pikat i referohen të njëjtës shkeljes nga neni i njëjtë, konstatuar në dy shërbime të ndryshme programore - RTM1 dhe RTM5. Ai informoi se për të dyja pikat do të jepet shpjegim i përbashkët, ndërsa diskutimi dhe vendimi do të zbatohet veçmas për secilën pikë.

Udhëheqësja e Spektorit për çështje programore, mr. Emilija Janevska, sqaroi se shkeljet në dy shërbimet programore të Radiotelevizionit të Maqedonasë janë konstatuar gjatë mbikëqyrjes së jashtëzakonshme të kryer sipas detyrës zyrtare. Ajo theksoi se lënda lidhet edhe me ankesë të paraqitur më parë nga një qytetar.

Në lidhje me shërbimin programor të RTM1, u përcaktua se në edicionet premierë dhe të ritransmetuara të programit për fëmijë "Fabrika Muzikore", të transmetuar më 23, 25, 27 dhe 29 mars, si dhe më 8, 10 dhe 12 prill 2026, është përdorur komunikim komercial audiovizual "plasim produkti", që është në kundërshtim me nenin 55, paragrafi 1 i Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, i cili përcakton se në cilat lloje programesh lejohet përdorimi i kësaj forme të komunikimit komercial.

Në lidhje me shërbimin programor të RTM5, Janevska sqaroi se është kryer kontroll në periudhën nga 6 deri më 12 prill 2026, gjatë së cilës është konstatuar se në edicionet e ritransmetuara të programit për fëmijë transmetuar më 11 dhe 12 prill 2026, gjithashtu është përdorur komunikimi komercial audiovizual "plasim produkti", i cili nuk lejohet në programet për fëmijë.

Për arsyet e lartpërmendura, për të dy shërbimet programore u propozua shqiptimi i masës paralajmërimi publik, në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit për harmonizim me detyrimet ligjore, pas së cilës do të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse u veprua sipas masave të shqiptuara.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli kërkoi sqarim shtesë në lidhje me ankesën e qytetarit që u përmend në arsyetim.

Mr. Emilija Janevska shpjegoi se në kohën kur u pranua ankesa, Agjencia kishte konstatuar tashmë një shkelje në kuadër të një mbikëqyrjeje tjetër dhe një mbikëqyrje e jashtëzakonshme sipas detyrës zyrtare tashmë është inicuar.

Votimi për pikën 4

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore, nr.10-1865/1 të datës 23.4.2026, me 6 vota "pro" dhe një "abstenim" nga Zirjeta Jajaga, arriti në përfundimin se NPR Radiotelevizioni i Maqedonasë - Televizioni i Maqedonasë - Shërbimi i parë programor - (RTM1) t'i shqiptoi masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, sepse më 23, 25, 27 dhe 29 mars dhe më 8, 10 dhe 12 prill 2026, në edicionet premierë dhe reprizë të programit për fëmijë "Fabrika Muzikore" përdori komunikim komercial audiovizual "plasim të produkteve", i cili nuk lejohet në programet për fëmijë.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (tekst i pastruar) nr.01-4241/1 të datës 1.10.2025, urdhërohet që NPR Radiotelevizioni i Maqedonasë - Televizioni i Maqedonasë - Shërbimi i parë programor - (RTM1), në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit për shqiptimin e masës paralajmërim publik, të harmonizojë punën e saj me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj subjektit të mbikëqyrjes në fjalë.

Spektori për çështje programore të kryejë mbikëqyrje kontrolli me qëllim përcaktimin nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar sipas masës së shqiptuar paralajmërim publik (tërësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar), pas skadimit të afatit të caktuar në aktin individual (aktvendimin) e miratuar nga Këshilli i Agjencisë.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Votimi për pikën 5

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e jashtëzakonshme programore, nr.10-1866/1 të datës 23.4.2026, me 6 vota "pro" dhe një "abstenim" nga Zirjeta Jajaga, arriti në përfundimin se NPR Radiotelevizioni i Maqedonisë Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i pestë programor - (RTM5) t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 55, paragrafi 1 i Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, sepse më 11 dhe 12 prill 2026, në edicionin reprizë të programit për fëmijë "Fabrika Muzikore" përdori komunikim komercial audiovizual "plasim produkti", i cili nuk lejohet në programet për fëmijë.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (tekst i pastruar) nr.01-4241/1 të datës 1.10.2025, urdhërohet që NPR Radiotelevizioni i Maqedonisë Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i pestë programor - (RTM5), në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit për shqiptimin e masës paralajmërim publik, të harmonizojë punën e saj me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

të Aktvendimit për shqiptimin e masës paralajmërim publik, të harmonizojë punën e saj me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj subjektit të mbikëqyrjes në fjalë.

Spektori për çështje programore të kryejë mbikëqyrje kontrolli me qëllim përcaktimin nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar sipas masës së shqiptuar paralajmërim publik (tërësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar), pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin individual (aktvendimin) e miratuar nga Këshilli i Agjencisë.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 6

Lidhur me këtë pikë, drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, informoi se në dhjetor 2024, në mbledhjen e mbajtur në ambientet e Agjencisë, menaxhmenti i Institucionit Publik Shëndetësor Spitali i Specializuar për Mjekësi Geriatrike dhe Paliative "13 Nëntori" kërkoi ndihmë financiare në shumë prej tre milionë denarësh për blerjen dhe instalimin e paneleve diellore dhe kolektorëve, me qëllim që të sigurohet një mënyrë më ekonomike për furnizimin me ujë të ngrohtë të pacientëve. Ai theksoi se Agjencia, duke marrë parasysh aftësitë e veta financiare, ndau donacion në shumë prej një milion denarësh, përkatësisht një të tretën e mjeteve (fondeve) të kërkuara. Pas miratimit të vendimit nga Këshilli, u kërkuar mendim nga Ministria e Drejtësisë, dhe Qeveria miratoi vendim me të cilin donacioni u përcaktua si donacion me interes publik. Drejtori informoi se pavarësisht faktit që mjetet u transferuan në llogarinë e institucionit shëndetësor më shumë se një vit më parë, deri në ditën e seancës, nuk ishin ndërmarrë aktivitete për realizimin e projektit për të cilin u është dhënë donacioni. Agjencia dy herë kontaktoi me institucionin shëndetësor, duke marrë përgjigje, por pa informacion konkret në lidhje me afatin ose dinamikën e realizimit të projektit. Përveç kësaj, dr. Trajçevski theksoi se më 22 prill 2026, kishte bisedë telefonike me drejtorin e institucionit, gjatë së cilës iu shpjegua se projekti nuk u realizua sepse dy institucione të tjera shtetërore, nga të cilat pritej të merrnin donacione shtesë, i kishin devijuar fondet për të ndihmuar viktimat në Koçan. Ai deklaroi se drejtorit iu kërkuar të jepte shpjegim me shkrim, së bashku me afatin konkret për realizimin ose fillimin e projektit, por deri në ditën e seancës, Agjencia nuk kishte marrë përgjigje me shkrim. Në konsultim me zyrën e avokatëve që përfaqëson interesat e Agjencisë, u përcaktua se ekzistojnë kushte për ndërprerjen e kontratës për donacion për shkak të mosrealizimit të qëllimit të synuar. Për këto arsye, u propozua që Këshilli të miratojë vendim për iniciimin e procedurës për ndërprerje me marrëveshje të kontratës dhe për të kthyer fondet në llogarinë e Agjencisë. Nëse institucioni shëndetësor nuk vepron sipas kërkesës për ndërprerjen me marrëveshje, u propozua iniciimi i procedurës përkatëse gjyqësore. Në të njëjtën kohë, të njoftohet dhe Ministria e Drejtësisë dhe Administrata e të Ardhurave Publike për situatën në fjalë.

Këshilltarja Gordana Majnova theksoi se, duke pasur parasysh situatën në sektorin e kujdesit shëndetësor, shpreh keqardhje që situata ka arritur në pikën ku po shqyrtohet ndërprerja e marrëveshjes së donacionit me këtë institucion shëndetësor. Ajo theksoi se ky është institucion i rëndësishëm në fushën e mjekësisë geriatrike dhe paliative dhe shprehu keqardhje që në periudhën e kaluar nuk janë shfrytëzuar mjetet për realizimin e projektit, veçanërisht duke pasur parasysh që institucionet publike të kujdesit shëndetësor kanë

mundësinë të sigurojnë mjete (fonde) përmes të ardhurave të tyre ose investimeve kapitale nga Ministria e Shëndetësisë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri pranoi Informacionin për mospërbushjen e detyrimeve kontraktuale nga ana e ISHP SBGMP 13 Nëntori Shkup, të përcaktuara në Kontratën për donacion, dhe dha miratimin që drejtori i Agjencisë të nënshkruajë Marrëveshje për ndërprerjen e Kontratës për donacion lidhur midis ASHMA-së dhe Institucionit Publik Shëndetësor - Spitali i Specializuar për Mjekësi Geriatrike dhe Paliative "13 Nëntori" Shkup.

Sektori për çështje juridike të njoftojë Ministrinë e Drejtësisë të RMV-së për marrëveshjen e paraqitur për ndërprerjen e kontratës për donacion, duke pasur parasysh se Ministria e Drejtësisë ka miratuar aktvendim në lidhje me donacionin në fjalë, duke e përcaktuar si donacion me interes publik në fushën e kujdesit shëndetësor.

Sektori për çështje juridike të njoftojë Administratën e të Ardhurave Publike për marrëveshjen e paraqitur për ndërprerjen e kontratës për donacion, si organ kompetent për kontrollin e dhënies, pranimin dhe shfrytëzimit të donacionit në rastet e zbatimit të stimujve tatimorë në përputhje me Ligjin për Donacionet dhe Sponsorizimet në Veprimtaritë Publike.

Nëse pranuesi i donacionit nuk e përmbush detyrimin që rrjedh nga Marrëveshja ose nuk e nënshkruan marrëveshjen për ndërprerjen e kontratës, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave, ASHMA do të inicon procedurë gjyqësore për pagesën e mjeteve financiare të alokuara.

Pika 7

Cvetanka Mitrevska, udhëheqëse e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, shpjegoi se bëhet fjalë për furnizim të shërbimit - dezinfektim dhe spërkatje nga insekte në ambientet e punës së Agjencisë, vlera e parashikuar e të cilit është nën pragun për zbatimin e dispozitave të Ligjit për furnizime publike, përkatësisht nën 1.000 euro, prandaj nuk është parashikuar në Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2026. Ajo sqaroi se mjetet për realizimin e shërbimit janë siguruar nga Planin Financiar i Agjencisë për vitin 2026. Ajo gjithashtu theksoi se të gjitha të dhënat relevante në lidhje me furnizimin në fjalë janë të përfshira në vendimin dhe në materialet e paraqitura për seancën.

Këshilltari Viktor Pavlovski kërkoi sqarime në lidhje me shpërndarjen e shpenzimeve, duke pasur parasysh se oferta arrin në 28.800 denarë, përkatësisht nëse gjysma e shumës do të mbulohet nga Ministria e Sportit.

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, sqaroi se shpërndarja e shpenzimeve nuk është në raport 50:50, por përcaktohet në përputhje me marrëveshjen e lidhur midis institucioneve dhe sipërfaqes katrore që ato shfrytëzojnë.

Kryetari i Këshillit, Sasho Stefanovski, sqaroi se shpenzimet shpërndahen në raport prej 65% që mbulohen nga Agjencia dhe 35% nga Ministria e Sportit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimit - dezinfektim dhe spërkatje nga insekte, në ambientet e punës, me vlerë nën pragjet për zbatimin e Ligjit për furnizime publike.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: dezinfektim dhe spërkatje nga insekte, në ambientet e punës, me vlerë nën pragjet për zbatimin e Ligjit për furnizime publike, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizime publike për

vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (tekst i pastruar) nr. 05-869/1 të datës 4.3.2026, dhe mjete janë siguruar nga Planin Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026.

Pika 8

Cvetanka Mitrevska, udhëheqëse e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, shpjegoi se bëhet fjalë për procedurë të furnizimit publik të shërbimit për mirëmbajtjen e faqeve të internetit të Agjencisë. Ajo theksoi se furnizimi është parashikuar në Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2026, dhe mjetet për realizimin e saj janë siguruar nga Planin Financiar i Agjencisë për vitin 2026. Ajo shpjegoi se procedura do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për furnizime publike që i referohen furnizimeve me vlerë të ulët, në përputhje me vlerën e caktuar të mjeteve të parashikuara për këtë furnizim. Në kuadër të lëndës së furnizimit, parashikohet mirëmbajtja e katër faqeve të internetit të Agjencisë. Ajo gjithashtu informoi se procedura do të fillojë me publikimin e njoftimit në Sistemin Elektronik për furnizime publike, dhe si kriter për dhënien e kontratës do të zbatohet çmimi më i ulët, duke përdorur ankand elektronik për ofertat e paraqitura. Ajo theksoi se të gjitha informacionet dhe detajet e tjera në lidhje me procedurën përmbahen në materialet e paraqitura për seancën.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimit: mirëmbajtja e faqeve të internetit të Agjencisë.

Zbatimi i procedurës së furnizimit publik për lëndën-e shërbimit: mirëmbajtja e faqeve të internetit të Agjencisë është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (tekst i pastruar) nr.05-869/1 të datës 4.3.2026, ndërsa mjetet janë siguruar nga Planin Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026.

Pika 9 - Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën "Të ndryshme".

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Përktheu: Antoneta Shabani